



## SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "LAN Group" Sh.P.K. të datës 07.09.2023 kundër njoftimit për kontratë 24.08.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 08.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me material higjenik për rezidentet e SHPMPPF" me nr. të prokurimit 616-23-8963-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "LAN Group" Sh.P.K. e datës 07.09.2023 kundër njoftimit për kontratë 24.08.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 08.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me material higjenik për rezidentet e SHPMPPF" me nr. të prokurimit 616-23-8963-5-2-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues për të publikuar formularin për korigjimin e gabimeve në njoftimeve të publikuara përmes të cilit do të bëj ndryshim/plotësimin e dosjes së tenderit sipas të gjeturave në këtë vendim dhe në përputhje të plotë me LPP.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "LAN Group" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "LAN Group" B.I. (tutje "parashtruesi") me datë 07.09.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë 24.08.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 08.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me material higjenik për rezidentet e SHPMPPF" me nr. të prokurimit 616-23-8963-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimet e parashtruesit cituar si në vijim:** *“1.Ne kundërshtim me ligjin janë kërkuar Referenca minimumi 10 mijë euro ndërsa nuk është kërkuar fare qarkullimi bankare apo i deklaruar andaj si mundet një OE të sjellë deshtimin Referencën pa qarkullim bankare . 2.Autoriteti Kontraktues shkeljen me të të rende e ka bërë që në Paramasë ka përdoruar emra tregtar si marken VANISH,FRESH ,ARKO që është në kundërshtim me LPP dhe RROUP-in 62 Shampon vanish për njolla 450-500 ml 56 Shampon për duar fresh me arom 1000 ml 54 Sapuna për rroje arko ose ekuivalent 75 gr 10 Detergjent i lëngëshëm për makinë të enëve berilon”.*

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësi kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe paralogarinë. Në këtë kontekst sektori i prokurimit ka kërkuar nga njësi kërkuese që të bëjë vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore. Me këtë rast njësi kërkuese ka udhëzuar që të bëhen ndryshim/plotësimet e nevojshme në dosjen e tenderit nëse evidentohet si e nevojshme për të evituar shkeljet potenciale të parimeve themelore të LPP për mos diskriminim/favorizim, ekonomikitet dhe efikasitet.

Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, paralogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit duke marrë parasysh edhe përgjigjet e njësisë kërkuese, ka gjetur se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit janë të bazuara. Kjo për arsye se kërkesat e dosjes së tenderit të cilave ju referohen pretendimet ankimore nuk janë në përputhje të plotë me paramasën dhe paralogarinë. Rrjedhimisht kërkesat e dosjes së tenderit të cilave ju referohen pretendimet ankimore duhet të riformulohen duke marrë parasysh qëllimin e aktivitetit të prokurimit ashtu që të evitohet çdo mundësi për të vepruar në kundërshtim me parimet themelore të LPP.

Duhet sqaruar po ashtu se përmes nenit 28 paragrafit 2 të LPP është përcaktuar se *“Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik”.* Po ashtu përmes nenit 7 paragrafit 2 të LPP është përcaktuar se *“Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik”.* Në këtë drejtim kufizimi i produkteve të caktuara në paramasë/dosje të tenderit me emër specifik përbën shkelje të parimeve themelore të LPP dhe dispozitave përkatëse të referuara si më sipër.


Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Për këto arsye është miratuar si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 14.09.2023**

**Visar SHEHU**  


Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.